BUJQESIA ORGANIKE

Drejtoria e Shërbimit Këshillimor,
Shkencës e Informacionit Bujqësor

Tel:+3554223269; 4223917
E-mail tana@icc-al.org
E-mail gezimxhixha@yahoo.com

BULETIN INFORMATIV
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
Nr.9 - 2007

Adresa: "Sheshi Skënderbej", Nr.2, Tiranë; Tel: + 4 232 796; Fax: + 4 227 924; www.mbumk.gov.al

KULTIVARËT E RRUSHIT PËR TAVOLINË MË TË PËRSHTATSHËM PËR PRODHIMIN

Zgjedhja e kultivarëve në bujqësinë biologjike nuk bëhet sipas një rregulloreje të përcaktuar. Megjithatë, duke qe në se kultivimi biologjik vështirësohet nga kufizimi i inputeve që përdoren, zgjedhja e kultivarëve të përshtatshëm për zonën mbetet një mundësi mjaft e vlefshme për këtë qëllim.

Aktualisht, vreshtat biologjikë në Shqipëri gjenden në zonën e ulët bregdetare, duke përfshirë Vlorë, Fier, Lushnjë, Kavajë, Durrës dhe Tiranë. Sipërfaqja totale e vreshtarisë Bio zë mbi 16 ha, ose afërsisht 10% të sipërfaqes Bio me fruta-perime.

Zgjedhja e kultivarit përmbledh në vetvete një sërë karakteristikash që duhet të plotësojë për të që në i përshtatshëm për kultivim Bio. Megjithatë, theksojmë që kultivari përbën një nga masat që konsiderojmë si të rëndësishëm në tërësinë e hallkave që kanë të bëjnë me kultivimin Bio të rrushit.

Në tabelën e mëposhtme jepen disa nga karakteristikat kryesore që duhet të mbajmë në konsideratë në zgjedhjen e kultivarit.

Kultivarët e rrushit për tavolinë që përdoren në Shqipëri janë kryesisht cv. të huaj. Më poshtë, mund të gjeni një përshkrim të karakteristikave kryesore të cv. *Victoria, Matilde, Black Magic, Kardinal, Italia, Red Globe, Michelle Palieri* dhe *Regina*, të konsideruar ndër më të rëndësishmit duke patur parasysh kërkesat dhe sjelljen e tyre ndaj kushteve klimatiko-tokësore, prekjes nga sëmundjet dhe dëmtuesit si dhe peshën ekonomike dhe vendin që kanë në strukturën varietore.

Permbajtja

Kultivaret e rrushit per tavoline te pershatashem per prodhimin bio	1
Kriteret per zgjedhjene kultivareve te rrushit dhe pershtatshmeria e tyre	2
Kultivari—*Viktoria*	3
Kultivari—*Black Magic*	4
Kultivari—*Kardinal*	5
Kultivaret *Matilde, Michele Palieri*	6
Kultivaret *Regina, Italia*	7
Kultivari *Red Globe*	8
Botime per Bujqesine Organike	9

KRITERET PËR ZGJEDHJEN E KULTIVARËVE NË BUQËSINË BIOLOGJIKE

Kultivari		Arsyet
Të përshtatshëm	Jo të përshtatshëm	
Vegjetacion të ekuilibruar	Vegjetacion të lartë	Mikroklimë më e mirë
Me pjekje të hershme (cikël të shkurtër)	Pjekje të vonë (cikël i gjatë)	Preket më pak nga sëmundjet dhe dëmtuesit
Me veshulë të shkrifët	Me veshulë të ngjeshur	Më pak probleme me kalbëzimet dhe dëmtuesit; përmirësohet shpërndarja e lëndëve aktive
Lëkurë të trashë	Lëkurë të hollë	Rezistencë më e madhe ndaj parazitëve
Me rezistencë të brendshme (të cv.)	Pa rezistencë	Preket më pak nga sëmundje/dëmtues
Me përputhshmëri të mirë shartimi me nënshartesat e	Me mos përputhje të shartimit	Mundësi më të mira përshtatje ndaj kushteve

Përshtatshmëria e kultivarëve të rrushit për tavolinë për prodhim

E MIRË	MESATARE	E ULËT
Victoria	**Italia**	**Maskat Hamburgu**
Black Magic	**Red Globe**	**Kardinal**
Matilde	**Muskat d 'Adda**	**Alphonse Lavellée**
Regina	**Michelle Palieri**	**Shesh i bardhë**
	Primus	**Black Pearl**
	Pizzutello	
	Afuz - Ali	

VICTORIA

Kultivari është *krijuar* nga Instituti i Kërkimit të Vreshtarisë i Dragasanit (Rumani), duke kryqëzuar llojet *Cardinal* dhe *Afuz Ali* (*Regina* e bardhë). Fillimisht e përhapur në Rumani, u zgjerua më vonë në

Greqi në zonat e Kavala dhe Calcidica ku gjeti një pëlqim të gjerë nga vreshtarët e zonës dhe qendrat tregtare europiane. Më pas, u soll në Itali, fillimisht në Grottaglie (Taranto), ku gjithashtu pati rezultate spektakolare të prodhimit në vitin e parë. Më vonë, u përhap mjaft në zonat e rrushit për tavolinë në Itali, veçanërisht në serra të mbuluara për hershmëri prodhimi.

Piqet nga fund i Korrikut deri në mes të Gushtit, por në ambiente të mbrojtura piqet që nga dekada e dytë e Korrikut.

***Veshuli* ka formë cilindrike** – konike, me peshë mesatare 700 – 800 gr, mesatarisht i ngjeshur, me rreth 76 kokrra. Gjatësia e veshulit është 22,7 cm.

Kokrrat kanë formë cilindrike – eliptike dhe pesha mesatare varion 9 - 10 gr.

Ka rezistencë të lartë ndaj shtypjes, dhe ndaj ndarjes nga bishti, por jo kur është tejpjekur. Lëkura është pak pruinoze dhe mesatarisht e trashë, tuli kërcitës, ka 2-3 fara.

Pjelloria reale mesatare është 1,4 veshulë për lastar. Për marrjen e prodhimeve të larta dhe cilësore nevojitet ujitje dhe plehrim korrekt. Duhet të kryhet heqja e veshulëve të tepërt dhe e kokrrave të vogla (që në disa vite mund të jetë konsistente).

Nga një bimë merren mesatarisht 24,5 kg. *Prodhimi* për ha kalon 300 – 350 kv.

Nënshartesat më të përdorura janë 1103P, 140 Ru, SO4.

Në mes të korrikut ka një përmbajtje sheqeri 16,2% (° Brix), 5,3 g/l aciditet total

dhe pH 4,1.

Kultivari është mjaft interesant, prodhues, në përhapje të vazhdueshme, duke zëvendësuar kultivarët e tjerë me farë që piqen në të njëjtën periudhë. Në ambiente të mbrojtura mund të zëvendësojë gjithashtu kultivarët e hershëm si *Regina dei Vigneti*, të karakterizuar nga kokrra të

BLACK MAGIC

Është krijuar nga Instituti i Vreshtarisë në Chisinau (Moldavi). Origjina gjenetike nuk njihet.

Piqet përgjithësisht në fund të Korrikut, ndërsa në ambiente të mbrojtur mund të vilet që në dekadën e fundit të Qershorit.

Veshuli ka peshë mesatare – të madhe 500 – 700 gr, me formë konike – piramidale, i shkrifët. Përbëhet nga rreth 80 kokrra dhe gjatësia e tij është 25,8 mm.

Kokrra ka ngjyrë blu në të zezë, me formë elipsoidale dhe peshë 6 gr. Ka një rezistencë të mirë ndaj çarjes dhe shkëputjes nga bishti i kokrrës. Përmban 1-2 fara. Pjelloria reale mesatare është 1,2 veshulë për lastar.

Ka nevojë për kryerjen e heqjes së veshulëve të tepërt për të mënjanuar fenomenin e kokrrave të vogla dhe rritjen e cilësisë për treg. Gjithashtu, ndërhyrjet për ujitje dhe plehrim duhet të jenë shumë të kujdesshme. Në disa vite me lulëzim të çrregullt, duhen shumë ditë punë për heqjen e kokrrave të vogla.

Prodhon 13,2 kg për bimë dhe rreth 300 kv për ha. Përshtatet mirë në nënshartesat 161.49, 1103P dhe 140 Ru. Arrin 17% sheqer, 5,1 g/l aciditet total dhe pH 3,9.

Ky kultivar u fut në vitin 1997 në strukturën varietore dhe menjëherë gjeti pëlqim në vreshtarët për hershmërinë e prodhimit dhe pamjen e veshulit. Mund të japë një prodhim mjaft cilësor kur ujitja, plehrimi dhe ngarkesa janë të ekuilibruara. Shpesh, ka nevojë për

heqjen e kokrrave të vogla, pasi vonojnë vjeljen. Mendohet të përhapet më gjerësisht në të ardhmen.

CARDINAL

Është krijuar në Kaliforni në 1939 nga E. Snyder dhe F. Harmon, duke kryqëzuar Flame Tokai x Ribier (Alphonse Lavallée).

Ekziston edhe një seleksion Kardinal i hershëm, që piqet 10 ditë përpara nga cv standard.Piqet nga fundi i Korrikut, ndërsa në ambiente të mbrojtura rreth 1 muaj

Veshuli është mesatar – i madh, me gjatësi 24,5 cm, i shkrifët, me indeks të ulët të kompaktësisë dhe mesatarisht 74 kokrra. Pesha mesatare është 720 gr.

Kokrra ka madhësi mesatare dhe peshë 9-10 gr. Lëkura është mesatarisht e trashë, pruinoze dhe me ngjyrë vjollcë jo uniforme. Ka 2-3 fara. Pjelloria reale mesatare për lastar është 1,4.

Nuk ka nevojë për ndërhyrje të veçanta. Ndërhyrje razionale me plehrim dhe ujitje mjaftojnë për marrjen e veshulëve të zhvilluar mirë. Megjithatë, është e vlefshme si dhe për cv të tjerë kryerja e t 'harrjes së veshulëve.

Prodhon mesatarisht 20,7 kg për bimë dhe 300-350 kv/ha. Ka dhënë rezultate të mira në nënshartesat 1103P, 140 Ru, 779P, 110 R dhe SO4.

Është ndër kultivarët më të vjetër të rrushit për tavolinë. Mbetet mjaft interesant për kultivimin në serra pa ngrohje, ku nga vjelja e parë rreth 10-20 Qershorit jep të ardhura mjaft të larta.

Në disa vite me ecuri klimatikë të disfavorshme (disekuilibra hidrikë dhe termikë) ose nga ujitjet e tepërta mund të paraqesë dëmtime të kokrrave, rënie të tyre ose fenomenin e kokrrave të vogla.

MATILDE

Ky kultivar është krijuar nga P. Manzo pranë Institutit Eksperimental për Pemtarinë në Roma, nga kryqëzimi i Italia x



Cardinal. Piqet nga fundi i Korrikut deri nga mesi i Gushtit, sipas zonave.

Veshuli është i madh (800 gr), me formë cilindrike-konike. Mesatarisht ka 88 kokrra, gjatësi 27 cm dhe është relativisht i shkrifët. Pesha e kokrrave është 7-8 gr. Kokrrat janë mjaft rezistente për shkëputjen nga bishti i tyre.

Pjelloria reale për lastar është 1,6 veshulë. Ka nevojë për ndërhyrje agronomike të veçanta si prerje e pjesës apikale të veshulëve, dhe t'harrje të veshulëve dhe kokrrave të vogla. Është një ndër kultivarët më prodhues (350 kv/ha) me rreth 21,9 kg/bimë. Në nënshartesat 1103 P dhe 140 Ru ka dhënë rezultate shumë të mira. Në mes të Korrikut, arrin 15,5% (gradë Brix), 5,1 g/l aciditet dhe pH 3,6.

Shpesh gjen mendime kontradiktore lidhur me këtë kultivar, veçanërisht në zona ku prodhimi vjen vonë dhe koha e pjekjes përkon me cv Italia (më i pëlqyer). Gjithashtu, në disa raste Victoria preferohet në mbjelljet e reja. Studime të mëtejshme janë të nevojshme sipas zonave të ndryshme. Është mjaft interesante në kultivimet e mbrojtura për hershmëri prodhimi, ku arrin të dalë rreth 1 muaj përpara.

MICHELE PALIERI

Michele Palieri ka ardhur nga kryqëzimi i kultivarëve Alphonse Lavallée x Red Malaga, dhe ka marrë emrin e krijuesit të tij. Piqet në dekadën e II-të të Gushtit.

Veshuli ka peshë mesatarisht të madhe (700 gr), formë cilindrike piramidale, dhe është mjaft i shkrifët. Gjatësia mesatare është 25,7 cm dhe përmban rreth 80 kokrra. Pesha e një kokrre është 8,9 gr, më lëkurë konsistente dhe rezistente. Përmban 3 fara.

Pjelloria mesatare për lastar është 1,1 veshulë. Nuk ka nevojë për shërbime të veçanta. Ujitja dhe plehrimi i duhur mjaftojnë për marrjen e një prodhimi mjaft cilësor. Prodhon rreth 350 kv/ha (23,2 kg/bimë). Shkon mirë në nënshartesat 1103 P, SO4 dhe 140 Ru.Është kultivar i fuqishëm, mjaft prodhues, jep prodhim mjaft cilësor me veshulë mjaft të zhvilluar, pamje të bukur, kokrra të mëdha dhe aromë.

REGINA

Origjina e kultivarit është Siria. Njihet edhe me emrin Razaki në ishujt e Egjeut, Afuz Ali në Bullgari e Shqipëri, Mennavacca në Puglia (Itali). Piqet nga mesi i Shtatorit.

Veshuli është i madh (700 gr), me formë cilindrike-piramidale, mesatarisht i shkrifët. Ka

rreth 80 kokrra dhe gjatësi 26,2 cm. Kokrra është e madhe (8,4 gr), me forme eliptike, lëkurë pruinoze, tul krokant (kërcitës). Pjelloria reale është 1,1 veshulë për lastar.

Nuk ka nevojë për ndërhyrje të veçanta për marrjen e prodhimeve cilësore. Prodhimtaria mesatare për bimë është 23,2 kg. Prodhimi për ha varion 300-350 kv. Kultivari shkon mirë me nënshartesat 1103P, 140Ru dhe 779P. Në mes të Shtatorit arrin 17-18% sheqer.

Regina është një kultivar mjaft i vlefshëm, i rezistueshëm në transport, dhe ka rezistencë më të mirë nga cv. Italia ndaj fiziopative kryesore të hardhisë. Ka qënë kultivar tepër i përhapur. Aktualisht, ka humbur disi terren por sidoqoftë mbetet gjithmonë një zgjedhje e mirë për vreshtarët.

ITALIA

Kultivari Italia është krijuar nga Prof. Alberto Pirovano, nga kryqëzimi i Bicane x Muskat Hamburgu. Është kultivari më i njohur, kultivuar dhe tregtuar në të gjithë botën. Piqet në fund të muajit Gusht. Në ambiente të mbrojtura mund të piqet në fillim të muajit. Gjithashtu, reziston mirë për prodhim të vonshëm, mund të qëndrojë në bimë për një kohë të gjatë duke ruajtur karakteristikat më të mira.

Veshuli është i madh (800gr), me formë konike-piramidale, mesatarisht i shkrifët, përbëhet nga rreth 80 kokrra mjaft rezistente. Gjatësia mesatare e veshulit është 22,4 cm. Kokrra është e madhe (10gr), me formë vezake, lëkurë pruinoze, konsistente, ngjyrë të verdhë me tul krokant. Përmban 2-3 fara.

Pjelloria reale mesatare për lastar është 1,2 veshulë. Për marrjen e prodhimeve të larta me veshulë të zhvilluar, duhet të kryhet t'harrja e veshulëve dhe kokrrave të vogla.

Gjithashtu, nevojiten ujitje dhe plehrim i kontrolluar. Kultivari është mjaft i ndjeshëm ndaj hirit. Është ndoshta kultivari më prodhues. Edhe me prodhime 400 kv/ha mund të merret rrush me cilësi të lartë. Ka nevojë për krasitje mesatare-të gjata (rreth 10-12 sytha për të katërta degët kryesore prodhuese. Shkon mirë me nënshartesat më të përdorura si 1103 P, Kober 5BB, 157.11 C, 140 Ru, 775 P.

Është kultivari që jep garanci më të mirë prodhuese dhe cilësore të produktit. Kultivohet gjerësisht edhe në SHBA, Afrikën veriore, Brazil, etj. Edhe pse kohët e fundit, cv. Victoria ka marrë një vlerë në rritje, mbetet kultivari kryesor i strukturës varietore mesdhetare të rrushit për tavolinë.

RED GLOBE

Është krijuar nga Prof. H.P. Olmo, i Universitetit Davis të California. Kultivohet dhe njihet tashmë në të gjithë botën.piqet në mes të Shtatorit, por vjelja mund të

shtyhet deri në Dhjetor kur mbulohet me plasmas. Ka veshulë shumë të zhvilluar, të mëdhenj me peshë 850-900 gr, mesatarisht kompaktë. Gjatësia e veshulit arrin 22,7 cm. Kokrrat kanë formë vezake-të rrumbullakët, peshë 10-12 gr. Lëkura është e hollë. Përmban 3-4 fara.

Pjelloria reale mesatare për lastar është 0,9 veshulë. Plehrimet dhe ujitjet e duhura mjaftojnë për marrjen e prodhimeve të mira. Është një ndër llojet e pakta që nuk ka nevojë për heqje të kokrrave të vogla. Është ndër kultivarët më prodhues. Edhe me prodhime mbi 400 kv/ha merren prodhim cilësor. Kultivari përshtatet mirë me nënshartesat me rritje mesatare si SO4, dhe 34 EM. Nuk shkon mirë me nënshartesën 1103 Paulsen.

Karakterizohet nga prodhimtari e lartë, pamje e bukur e veshulëve, njihet në tregje të ndryshme. Piqet pak a shumë në një kohë me cv. më të njohur Italia, kështu zgjedhja shpesh varet vetë fermerët.

6. Botime per bujqesise organike

Një bibliotekë e pasur pranë Drejtorisë së Shërbimit Këshillimor, Shkencës dhe Informacionit Bujqësorë në MBUMK-në, (Projekti PAB)

Kjo qendër funksionon dhe mbështetet nga *"Projekti i integruar për përhapjen dhe asistencën teknike në zbatimin e metodave të prodhimit*

organik (PAB)". Qendra shërben si një pikë fokale per koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve që po kryhen në kuadrin e projektit. Ajo gjithashtu po luan një rol të rëndësishëm për krijimin e një rrjeti informativ për bujqësinë biologjike (organike); do të ofrojë asistencë teknike (përfshirë edhe atë *on-line)* si dhe informacion për të ndihmuar vendim-marrjen në ferma, nëpërmjet një programi të posaçëm kompjuterik.

Në kuadër të zgjerimit të saj janë të mirëpritur libra nga autorë të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj.

Pranë qendrës mund të konsultohen edhe artikuj të ndryshëm të 13 periodikëve ndër më të njohurit e bujqësisë, Shërbimit Këshillimor dhe Bujqësisë bio, si: ***Informatorio Agrario,***
Informatorio Fitopatologico,
Frutticoltura, Colture protette, The Journal of Agricultural Education and Extension, AZ Bio, BioActualité,
Terra e Vita,
Ecology and Farming, Medit, etj.

Këto botime dhe artikuj janë kataloguar në polin italian SEBINA (www.sinab.it)
(Sistemi kombëtar italian i informacionit mbi bujqësinë biologjike). Midis bibliotekave që bëjnë pjesë në këtë pol, mund të shkëmbehen materiale dhe artikuj nëpërmjet fax, etj. Pranë zyrës së projektit PAB, mund të konsultohen dhe fotokopjohen materiale të ndryshme për të gjithë të interesuarit.

Hyrje të reja pranë bibliotekës PAB

Alimentazione della vacca da latte i Vittorio Dell'Orto dhe Giovanni Savoini. Ky libër paraqet aspekte të të ushqyerit të lopëve për qumësht, për marrjen e qumështit me standard të lartë cilësie. Botuar nga Edagricole, ka 268 faqe.

Orticoltura specializzata e Luciano Trentini dhe Giorgio Sitta. Libri përshkruan kultivimin e mbrojtur të perimeve, në veçanti për kulturat asparagus, pjepër, domate dhe kungull. Botim i vitit 2001.

Manuale di frutticoltura i Carlo Edoardo Branzanti dhe Angelo Ricci. Manuali jep një panoramë të plotë të fazave dhe periudhave të pemëve frutore, zgjedhja e ambientit dhe distancat e mbjelljes së kulturave të ndryshme, llojet kryesore të krasitjes dhe në veçanti për farorët, bërthamorët, kivin, menaxhimin e pjellorisë së tokës, etj. Botim i Edagricole, 2001, ka marrë vlerësime pozitive nga shumë kritikë si Giorgio Bargioni, etj.

Lotta biologica i M. Ferrari, E. Marcon dhe A. Menta. Libri përshkruan agroekosistemin në tërësi, menaxhimin e integruar të dëmtuesve, dhe menaxhimin biologjik me anë të predatorëve, parazitëve, mikroorganizmave dhe aktorëve të tjerë që ndihmojnë në uljen e popullatave të dëmtuesve. Botim i vitit 2000, ka 355 faqe.

Progetto finanziato dal Fondo Europeo di Sviluppo Regionale

http://pab.iamb.it

Drejtoria e Shërbimit Këshillimor, Shkencës e Informacionit Bujqësor

Tel:+3554223269; 4223917
E-mail tana@icc-al.org
E-mail gezimxhixha@yahoo.com

Istituto Agronomico Mediterraneo di Bari

Tel. +39/080/4606304
Fax +39/080/4606268
E-mail pab@iamb.it